



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	Nr Prot.
Dep. <u>ED/DPK</u>	Bi Prot.
Dep.	Prot No. <u>01-1091/16</u>
Nr.faq.	Data
Broj. stranica	Datum
Nr. pages <u>02</u>	Date <u>14.03.2016</u>
PRISHTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 14.03.2016, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-4640/15, për zyrtarin e lartë z. Luan Jusufi, Këshilltar Politik në Ministrinë e Punëve të Brendshme, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të Interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli AKK-03-02-4640/15, qe për trajtim ka pasur zyrtarin e lartë z. Luan Jusufi, Këshilltar Politik në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Gjatë zhvillimit të procedurës për identifikimin e rasteve të konfliktit të interesit, është vërejtur se zyrtari i lartë z. Luan Jusufi, Këshilltar Politik në Ministrinë e Punëve të Brendshme, figuron si bashkëpunues dhe person i autorizuar në një biznes privatë e që sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik Nr.04/L- 051, kjo situatë paraqet konflikt të interesit dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korrupsionit me datën 22.02.2016. e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet qe posedon Agjencia.

Pas kësaj shkrese z. Luan Jusufi, ka kontaktuar me zyrtarët e AKK-së, dhe është interesuar për një takim me zyrtarët e AKK-së për tu njoftuar me gjerësisht për situatën në të cilën gjendet.

Ne takimin e organizuar ne zyrat e AKK-së z. Luan Jusufi, është njoftuar nga zyrtaret e AKK-së, me faktet qe posedon Agjencia lidhur me rastin e iniciuar.

z. Luan Jusufi, në këtë takim është pajtuar me gjendjen por është arsyetuar se biznesi ne fjalë nuk është aktiv dhe nuk zhvillon veprimtari pasi qe ai si bashkaksionar është tërhequr nga ky biznes dhe nuk ka qen i informuar se kjo situatë është ne kundërshtim me ligjin ne fuqi, por është zotuar se brenda afatit ligjor do te bej ndryshimet dhe do te veproj sipas ligjit ne fuqi për ta parandaluar situatën e konfliktit të interesit.

Me datën 11.03.2016, nga z. Jusufi, kemi pranuar dokumentin zyrtar të lëshuar nga ARBK-ja, ku dëshkohet se z. Luan Jusufi, nuk figuron me si person i autorizuar ne biznesin privat me emër "ASL"SH.P.K me nr.70832739.

Vlerësojmë se pas veprimeve të ndërmarra nga z. Luan Jusufi, Këshilltar Politik në Ministrinë e Punëve të Brendshme, duke bërë ndryshimet e parapara me ligj, duke u larguar nga personi i autorizuar ne biznesin privatë janë krijuar rrethana të reja dhe është shmangur gjendjen e mundshme e konfliktit të interesit dhe papajtueshmërisë ne ushtrimin e funksionit publik, dhe u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja,

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari kontaktues)

Hasan Preteni
Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

